

CILËSIA E UJIT NË SISTEMIN SHPËRNDARËS

Përshkrimi i kursit

Misioni dhe përgjegjësia kryesore e Shoqërive Ujësllës Kanalizime është furnizimi me ujë të pijshëm të sigurt dhe në përpudhje me standartet dhe rregulloret ekzistuese.

Një sistem furnizimi me ujë të pijshëm konsiderohet cilësor kur nuk përmban organizma patogjene që shkaktojnë sëmundje. Gjithashtu, kur nuk përmban kimikate toksike, kur është i mirë në shije dhe në dukje, duke u bërë kështu i pranueshëm për konsumatorët familjarë.



Ky kurs trajnimi do t'ju shërbejë personave që punojnë në Shoqëritë Ujësllës Kanalizime të njohin transformimet kimike, fizike dhe biologjike të ujit, kur futet dhe qarkullon në rrjetin shpërndarës. Gjithashtu, do të shpjegojë dhe prezantojë programet për monitorimin dhe mbikqyrjen e rrjetit.

Procesi i dezinfektimit dhe pikat e aplikimit të klorit do të trajtohen gjithashtu në mënyrë të zgjeruar, gjatë këtij kursi.

Kush duhet të marrë pjesë

Ky kurs është hartuar për profesionistët e shoqërive ujësllës kanalizime dhe është veçanërisht i vlefshëm për drejtorët e departamentit teknik dhe të shpërndarjes, inxhinierët e mirëmbajtjes dhe të shfrytëzimit, inxhinierët e matjes, teknikët e bilancit, si dhe menaxherët e faturimit dhe arkëtimit.

Kursi është me interes dhe për inxhinierë konsulentë, inxhinierë projektues, zyrtarë të shëndetit publik, apo institucione të tjera rregullatore dhe të ngjashme.

Objektivat e kursit të trajnimit

Në fund të këtij kursi trajnimi, ju do të jeni të aftë të:

- Identifikojnë burimin dhe llojet e ndotësve që futen në sistemin shpërndarës të ujit;
- Zhvillojnë një program mbikëqyrjeje për sistemin e shpërndarjes së ujit;
- Të realizojnë një program për monitorimin e cilësisë së ujit në sistemin shpërndarës;
- Të parandalojnë lidhjet e kryqëzuara dhe të zhvillojnë një program për kontrollin e tyre;
- Të njohin faktorët që ndikojnë në dezinfektim dhe disa nga metodat e dezinfektimit;
- Të kryejnë dezinfektimin e pompave, tubacioneve të ujit, dhe objekteve të ruajtjes;
- Të identifikojnë pikat e aplikimit të klorit.

Metoda e trajnimit

Trajnimi është i bazuar në leksione të prezantuara në Power Point, të ndërthura me diskutime dhe raste studimore. Përveç marrjes së leksioneve dhe diskutimeve, pjesëmarrësit do të analizojnë raste konkrete dhe angazhohen, në zhvillimin e ushtrimeve dhe punëve laboratorike.

Materialet e kursit të trajnimit

Si pjesëmarrës në këtë kurs, ju do të pajiseni me Manualin e Trajnimit "Cilësia e Ujit në Sistemin Shpërndarës". Përpos kësaj, ju do të pajiseni me çertifikatë e cila dëshmon pjesëmarrjen tuaj në këtë trajnim.

Tarifa e regjistrimit

Anëtarët e SHUKALB/SHUKOS: 22,000 lekë për person

Jo-anëtarët: 25,000 lekë për person

Kjo tarifë përfshin materialet e kursit, drekat, dhe pushimet për kafe.